



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 85/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.02.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me nr. REF-82940-12-23-2020, me objekt: Loti 2 “*Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror*”, me fond limit 62.981.351,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: “C.E.C Group” sh.p.k.
Rruga “Dritan Hoxha”, Nd.117, Shk.2, Ap.5/3, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për*

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pa i hyrë vlerësimit të çështjes *ratione materiae*, vlerëson të ndalet tek respektimi i kërkesave formale (afateve) të ankimimit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me nr. REF-82940-12-23-2020, me objekt: Loti 2 “*Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror*”, me fond limit 62.981.351,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 05.01.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) për procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 21.01.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave (short-listing) të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 21.01.2021 operatori ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Referuar materialeve të administruara, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit, në datën 22.01.2021, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.755/2 prot., datë 01.02.2021, trajtim i ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 10.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Në datën 24.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*”, me nr. REF-82940-12-23-2020, me objekt: Loti 2 “*Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror*”, me fond limit 62.981.351,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

III.2. Në datën 05.01.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë (shprehje interesi) për procedurën e prokurimit.

III.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor në datë 21.01.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave (short-listing) të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

III.4. Në datën 21.01.2021 operatori ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

III.5. Referuar materialeve të administruara, si dhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ky i fundit, në datën 22.01.2021, ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor me anë të të cilit kundërshton vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III.6. Referuar materialeve të administruara, parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se është dorëzuar gjithashtu edhe akti administrativ nr.755/2 prot., datë 01.02.2021, trajtim i ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor, akt për të cilin, gjithashtu operatori ekonomik ankimues pranon se ka marrë dëgjimi në datën 01.02.2021.

III.7. Në datën 10.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

III.8. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. *Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.*

1.1 *Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.*

2. *Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dëgjimi ose duhet të ishte vënë në dëgjimi për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*

5. *Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.*

6. *Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.*

III.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar si edhe parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se ankesa e operatorit ekonomik ankimues është depozituar pranë autoritetit kontraktor në datën 22.01.2021, me nr. 755 prot., referuar kjo shkresës kthim përgjigje Nr.755/2 Prot., datë 01.02.2021, të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik nga ana e autoritetit kontraktor, dokument ky për të cilin ankimuesi është vënë në dëgjimi, pasi e ka paraqitur bashkëngjitur ankesës së tij të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Operatori ekonomik pranon se në datën 01.02.2021 ka marrë djeni për kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor me shkresën që mban të njëjtën datë 01.02.2021.

Rezulton se pas kthimit të përgjigjes nga autoriteti kontraktor, ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datën 10.02.2021.

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar”, parashikohet se, ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim *brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor.*

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimesi ka ezauruar ankimin administrativ pranë autoritetit kontraktor brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 2 të L.P.P.-së. Me marrjen e ankesës në dorëzim nga autoriteti kontraktor, ky i fundit ka detyrimin ligjor të shqyrtojë ankesën dhe të marrë një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

Mosrespektimi i afatit të sipërcituar nga ana e autoritetit kontraktor nuk çënon në asnjë rast pozitën e operatorëve ekonomikë ankimesi, pasi kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar edhe momentin procedural të nisjes së llogaritjes së afateve ligjore për ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit të parashikuar nga neni 63 pika 5 të LPP-së.

Sa më sipër, K.P.P konstaton se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimesi më datë 10.02.2021 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituar, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë. Në rastin konkret ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 10.02.2021, është depozituar në tejkalim të afateve ligjore .

III.10. Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

III.11. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimesi, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës”, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.12. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të

shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C Group” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, me nr. REF-82940-12-23-2020, me objekt: Loti 2 “Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Qendror”, me fond limit 62.981.351,41 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 225 Protokoli,

Datë 10.02.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri